

VENDIM
Nr. 344, datë 4.5.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSION DHE SHITESË TË TEATRIT “ANDON ZAKO ÇAJUPI”, KORÇË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikonstruksion dhe shtesë të teatrit “Andon Zako Çajupi”, Korçë”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Korçë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “sipërfaqe, tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 2 477 604 (dy milionë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e katër) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 477 604 (dy milionë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
 6. Shpronësimi të fillojë në datën 11.5.2016.
 7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumen-tacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Korçë.
 8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN
PËR PROJEKTIN “RIKONSTRUKSION DHE SHITESË TË TEATRIT “ANDON ZAKO ÇAJUPI” KORÇË”

NR.	EMËR E MBIEMËR	ZONA KADASTRALE	NR. PASURIE	LLOJI I PRONËS	SIPËRFAQE M²	VLERA ME PREVENTIV	ADRESA E PRONARIT	SHËNIM
1	Shpatore Bejko	8561	4/10-N15	Njësi shërbimi	37.80	1,719,652	Lagjja nr. 9, Sheshi i Teatrit nr. 35 H.5 Korçë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	B/P Thanas, Dionis, Varvara, Pandeli, Martin, Zhuljeta, Sofika, Venijamin Napuce	8561	4/10-N1	Njësi shërbimi	18	757,952	Lagjja nr. 3, rruga “Gjako Koroveshi”, nr. 19, Korçë	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	SHUMA					2,477,604		